



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE/PRANIMIN NË SHËRBIM CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Lloji i diplomës

“Inxhinieri Elektronike/Teknologji Informacioni”

Niveli minimal i diplomës “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VI, të Vendimit nr.243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- 2 (Dy) Specialistë, Sektori i Monitorimit të Frekuencave, Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK -Kategoria e pagës IV-1;

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakat, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PER LEVIZJE PARALELE: 19.07.2023

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL: 25.07.2023

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Planifikimi dhe administrimi i frekuencave duke analizuar disponueshmërinë e tyre të cilat do të vihen në dispozicion për ofrimin e shërbimeve audio/ audiovizivë
- Përlllogaritje e përqindjes së mbulimit të territorit me shërbim audio dhe /ose audiovizive(në bazë të zonës së licensimit nga subjektet e licencuar në AMA.
- Përgatitja e planit të përdorimit të frekuencave audio/audiovizive.
- Pasqyron ndryshimet në planin e përdorimit të Frekuencave dhe pas çdo vendim të AMA-s;
- Përgatitja e dokumentacionit teknik ku përfshihen specifikimet e karakteristikave teknike të transmetimit dhe përgatitja e relacioneve përkatës për AMA-n, lidhur me dhënien në përdorim të frekuencave subjekteve që aplikojnë për licencë.
- Llogaritja e niveleve të interferencave nga rrjetet e tjera egzistuese dhe të planifikuar
- Llogaritja e mbulimit të rrjeteve analoge dhe numerike të operatoreve kombëtar e vendor radio dhe televizivë;
- Përgatitja e relacioneve dhe dokumentacione teknike për subjektet që aplikojnë për licencë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Plotësimi dhe administrimi i bazës së të dhënave që disponon Sektori dhe ndjekja e korespondencave.
- Verifikon dhe analizon dokumentacionin teknik të përgatitur në kuadër të çeljes së garave për dhënie në përdorim të frekuencave.
- Bashkëpunon me drejtoritë e tjera lidhur me përditësimin e bazës së të dhënave që disponon sektori.
- Monitoron brezat e frekuencave të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për transmetime audiovizive, me qëllim përdorimin e frekuencave të dhëna në licencë, të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në zbatim të kushteve të licencës.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

I.1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria IV-1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” Inxhinieri Elektronikë/Teknologji Informativ. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë mbi një vit eksperiencë pune në nivel ekzekutiv;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

I.2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 19.07.2023

I.3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës. 19.07.2023 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Pas kësaj date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:
 - Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
 - Njohuri në lidhje me legjislacionin e shërbimit civil;
 - Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
 - Njohuri mbi VKM Nr. 292, date 2.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”.
 - Njohuri mbi VKM Nr. 466, date 27.02.2013 “Per miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

I.5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Pikën I.4 të përmendur më sipër;
- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

I.6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Për kandidatet që aplikojnë nga jashtë sistemit të shërbimit civil



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatet jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për plotësimin e vendit të lirë.

II.1-Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master profesional” Inxhinieri Elektronike/Teknologji Informacioni. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të ketë mbi 1 vit eksperiencë pune në profesion.

II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 25 korrik 2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

- Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”I ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me legjislacionin e shërbimit civil;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi VKM Nr. 292, date 2.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”.
- Njohuri mbi VKM Nr. 466, date 27.02.2013 “Per miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

II.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

II.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Autoritetit dhe në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë.